



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 222/12 Prot.

Gramsh, më 02.02.2024

V E N D I M

Nr. 5, date 26.01.2024

MBI

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM/HEQJES TË SIPËRFAQEVE  
TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH.**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 26.01.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, në mbështetje të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni 25 pika1, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar, bazuar në nenin 54 gërma "e", gërma "k", nenin 3 gërma "ç", nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4 të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Ministrisë së Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", në zbatim të VKM-së nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar dhe VKM-së nr.267, datë 27.04.2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.559, datë 29.07.2022 e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Këshilli Bashkiak Gramsh ;

V E N D O S I :

- 1.Të miratojë në parim dhënien në përdorim/heqjen të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor publik që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Gramsh.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT  
ENIS ZANI

